


REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA E NOTERËVE TIRANË

Nr. 1283Rep.



VËRTETIM  
(Njësimi)

Sot, më datë 21.09.2018 para meje Noteres në zyrën time të noterisë, me adresë; Rr: "At Gjergj Fishta", kulla nr. 9, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, u paraqit :

Daniela Ndrejaj, e identifikuar me ID me nr.personal J06123035Q , e cila paraqitet për të njësuar me origjinalin dokumentet ligjore të mëposhtëme:

Dokumente Ligjore, ku unë noteria vërtetoj që dokumentet nuk kanë fshirje, as korrigjime dhe njësia është kopje e njëjtë me dokumentin origjinal të fotokopjuar nga une noterja .

Vërtetimi i dokumentit u hartua në bazë të nenit 56 te Ligjit Nr. 7829, dt. 01.06.1994 "PER NOTERINE" ( i ndryshuar) dhe Udhezimit te Ministrit te Drejtesise, Nr. 6891, dt. 17.08.2005 pika 7 e tij .

Pasi iu lexua personit dhe iu bë e qartë përmbajtja, unë Noterja e vërtetoj nënshkrimin sipas Ligjit.



*[Handwritten signature]*



Small, illegible markings or faint text located in the lower left quadrant of the page.



NOTERE, Merita Kostanica

Prishtinë

Numri Rendor LRP 5058/2018

Numri i Referencës LRP 890/2018

MARRËVESHJE MES AKSIONARËVE TË SHOQËRISË "GAZETA EXPRESS" SH.P.K. PËR HAPJEN E DEGËS SË SHOQËRISË NË VEND TË HUAJ-----

Me datë 11.09.2018 (njëmbëdhjetë shtator dymijë e tetëmbëdhjetë) para meje, Merita Kostanica, Notere me seli zyrtare në Rr."Zahir Pajaziti", Hyrja, Nr. 20, Kati 1, Numër 1, Prishtinë, me kërkesë që në bazë të vullnetit të tyre të lirë të përpilojë aktin noterial si në titullin më sipër janë paraqit:-----

1. BERAT BUZHALA, i lindur në Çabiq me datë 22.11.1975, emri i babës Bashor, sipas deklaratës së tij me adresë në Veternik, Mbrapa Grand Store, Prishtinë 10000, Kosovë, identiteti i të cilit është konstatuar nga letërnjoftimi me numër personal 1013396767, i lëshuar nga MPB me datë skadimi 28.08.2027;-----
2. VJOLLCA MUSA, e lindur në Mitrovicë me datë 07.03.1963, emri i babës Hashim, sipas deklaratës së saj me adresë në Bregu i Diellit, Zona Perendim Hyrja 4/13, Prishtinë, identiteti i të cilit është konstatuar nga letërnjoftimi me numër personal 2003940317, i lëshuar nga MPB, me datë skadimi 22.11.2026;-----
3. ARTAN LAHAJ, i lindur në Gjakovë me 10.05.1978, emri i babës Haxhi, me adresë në Rr. Kalabria, blloku B2, Llamella B nr.26, Prishtinë 10000, Kosovë, me numër personal me numër personal 1001144703, përfaqësuar me autorizim (bashkangjitur si shtojcë 1) nga VJOLLCA MUSA, me të dhënat e lartëshënuar;-----
4. LEONARD KËRQUKU, i lindur në Gjakovë me datë 05.11.1981, emri i babës Mark, sipas deklaratës së tij me adresë në Lägja 038 pa numër Veternik, Prishtinë 10000, Kosovë, identiteti i të cilit është konstatuar nga letërnjoftimi me numër personal 1001478342, i lëshuar nga MPB me datë skadimi 13.10.2025;-----
5. SHPEND LIMONI, i lindur në Gjiçan, me datë 18.11.1979, emri i babës Ibrahim, sipas deklaratës së tij me adresë në Hodonoc, pa numër, Kamenicë, Kosovë, identiteti i të cilit është konstatuar nga letërnjoftimi me numër personal 1003064421, i lëshuar nga MPB me datë skadimi 01.02.2027;
6. ARBEN HYSENI, i lindur në Pejë, me datë 09.05.1984, emri i babës Simon, sipas deklaratës së tij me adresë në Rr. "Sali Çeku", Dardania 1, Pejë, identiteti i të cilit është konstatuar nga letërnjoftimi me numër personal 1009408106, i lëshuar nga MPB me datë skadimi 20.07.2025;-----



Të gjithë, në cilësinë e aksionarëve të vetëm të N.B. "Media Works" Sh.p.k., e regjistruar pranë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, me numër të regjistrimit të biznesit 70202640, me seli në Prishtinë, Rr. Perandori Justinian, numër 69, konstatuar nga Informata mbi Biznesin të sjella nga vetë pala te Noterja, si dhe konstatuar nga ueb site i Agjencionit për Regjistrim të Biznesit Kosovës në ditën e nënshkrimit të këtij akti (bashkangjitur si shtojcë 1), ndërsa, N.B. "Media Works" Sh.p.k., në cilësinë e aksionarit të vetëm të "GAZETA EXPRESS" SH.P.K. e regjistruar pranë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, me numër të regjistrimit të biznesit 810104183, me seli në Perandori Justinian, numër 69, Prishtinë, konstatuar nga Informata mbi Biznesin të sjella nga vetë pala te Noterja, si dhe konstatuar nga ueb site i Agjencionit për Regjistrim të Biznesit Kosovës në ditën e nënshkrimit të këtij akti (bashkangjitur si shtojcë 2), me të dhënat e tjera, sic është përshkruar më posht në këtë Marrëveshje. -----

Kopjet e dokumenteve identifikuese të palëve janë bashkangjitur si shtojcë 1. -----

Pasi që Noterja u bind në vullnetin e lirë të palëve, aftësinë e tyre të plotë të veprimit dhe pas shpjegimeve për shtrirjen juridike dhe pasojat e këtij akti noterial, duke ju përmbajtur dispozitave të Nenit 2, 3, 30.2 dhe neneve 33-38 të Ligjit për Noterinë, nenit 33, 102, 103, të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, por edhe dispozitave të tjera të ligjeve përkatëse, dhe ligjeve tjera në fuqi, palët e pranishme kanë shpjeguar dhe deklaruar se pajtohen si në vijim: -----

-----NENI 1.SHPJEGIM-----

Palët kanë sjellë para Noteres: -----

1. Informata mbi Biznesin të datës 15.03.2018, për shoqërinë "GAZETA EXPRESS" SH.P.K. (bashkangjitur si shtojcë 2), në bazë të së cilave konstatohet se e njëjta ka specifikat si në vijim: ----
  - a) me numër regjistrimi biznesi: 810104183; -----
  - b) me seli në: Perandori Justinian, numër 69, Prishtinë;-----
  - c) me kapital të regjistruar në shumë prej: € 1,000; -----
  - d) me aktivitetet e regjistruara si më poshtë: -----
    - 6312 Web portalet- Primarë; -----
    - 7311 Agjencitë për publicitet- Sekondarë; -----
    - 7320 Hulumtimi i tregut dhe matja e opinionit publik (sondazhet)- Tjera; -----
    - 5813 Publikimi i gazetave- Tjera; -----
    - 5819 Aktivitetet e tjera botuese- Tjera; -----
    - 6391 Aktivitetet e agjencive të lajmeve- Tjera; -----
    - 1811 Shtypja e gazetave- Tjera. -----
  - e) me aksionarë sic është shënuar më sipër, dhe Drejtor BERAT BUZHALA me të dhënat si më sipër. -----


2. Tutje, palët sipas kësaj Marrëveshje, deklarojnë se dëshirojnë të bëjnë hapjen e Degës së Shoqërisë "GAZETA EXPRESS" SH.P.K., edhe në Shqipëri, andaj të njëjtit pajtohen si në vijim: -----

NENI 2. OBJEKTI

1. Aksionarët e N.B. "Media Works" Sh.p.k., si aksionar i vetëm i "GAZETA EXPRESS" SH.P.K., pajtohen ndërmjet vete dhe marrin Vendim, për hapjen e Degës së "GAZETA EXPRESS" SH.P.K., në Shqipëri, me të dhënat si më poshtë:
  - a) emri i Degës së "GAZETA EXPRESS" SH.P.K., në Shqipëri do të jetë: "Gazeta Express Tiranë";
  - b) selia e Degës do të jetë në adresën: Rr. Barrikada, njësia 3, shkalla 1, Tiranë;
  - c) aktivitetet e Degës do të jenë si më poshtë:
    - Web Portalet – do të jenë aktivitet Primarë;
    - Prodhimi i Produkteve Televizive – do të jenë aktivitet Sekondarë;
    - Hulumtimi i Tregut/Matja e Opinioneve- do të jenë aktivitetet e Tjera;
    - Aktivitetet e agjencive te lajmeve- do të jenë aktivitetet e Tjera;
  - d) Autorizohet Znj. DANIELA NDREJAJ, shtetase Shqiptare e pajisur me numër identifikimi 033357057 të kryejë regjistrimin e Degës pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në Shqipëri dhe pranë autoriteteve të tjera sic kërkohet nga legjislacioni Shqiptar;
  - e) person përgjegjës për administrimin e Degës është BERAT BUZHALA me numër personal 1013396767;
2. Palët deklarojnë se regjistrimi i Degës së "GAZETA EXPRESS" SH.P.K., në Shqipëri do të jetë në përputhje me Ligjin e Aplikueshëm në Shqipëri.
3. Për të gjitha veprimet të cilat nuk janë specifikuar në këtë Akt, do të vlejnjë dispozitat e përcaktuara në bazë të „MARRËVESHJE TË SHOQËRISË TË GAZETA EXPRESS SH.P.K.” e datës 12.03.2018, dhe "STATUT TË GAZETA EXPRESS SH.P.K.", i datës 12.03.2018.

NENI 3. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

1. Kësaj Marrëveshje, i janë bashkangjitur:
  - 1) Dokumentet identifikuese të palëve, autorizim për përfaqësim për ARTAN LAHAJ, Informata mbi Biznesin të shoqërisë N.B. "Media Works" Sh.p.k
  - 2) Informata mbi Biznesin të shoqërisë "GAZETA EXPRESS" SH.P.K..
2. Shpenzimet noteriale për përpilimin dhe vërtetimin e këtij Akti janë llogaritur dhe paguar në bazë të nenit 26 pikës 2.1, të Udhëzimit Administrativ 02/2012 për Tarifat e Përkohshme Noteriale në vlerë prej € 150 (njëqind e pesëdhjetë euro) + TVSH, si dhe shuma në vlerë prej € 45 (dyzet e pesë euro) + TVSH, sa i përket numrit të palëve, në total shuma në vlerë prej € 195 (njëqind e nëntëdhjetë e pesë euro) + TVSH.
3. Ky Akt noterial është përpiluar në një origjinal i cili mbetet në zyrën e noteres në përputhje me nenin 3 të Ligjit për Noterinë (03/L-101). Ndërsa i njëjti Akt në formë ekzemplari, me përmbatje,



formë dhe në çdo aspekt është identik me origjinalin i lëshohet palëve. I njëjti është përpiluar në 4 faqe / 2 fletë.

4. Palët janë pajtuar që në rast të ndonjë kontesti eventual në mes tyre, Gjykata Themelore në Prishtinë të caktohet si gjykatë kompetente për zgjidhjen e kontestit.
5. Palët e paraqitura dëshmojnë identitetin e tyre dhe ashtu siç është shënuar, ata kanë fuqi veprimi. Noterja e ka lexuar aktin noterial në prani të palëve, palët të njëjtin e pranojnë dhe me dorë të vet e nënshkruajnë, kurse pas tyre të njëjtin e nënshkruan Noterja. Veprimi i noterizimit u zhvillua pa ndërprerje, në zyrën e Noteres në selinë e Noterës, me 11.09.2018 (njëmbëdhjetë shtator dymijë e tetëmbëdhjetë).

NËNSHKRIMET E PALËVE

N.B. "Media Works" Sh.p.k. në cilësinë e aksionarit të vetëm të "GAZETA EXPRESS" SH.P.K., përfaqësuar nga:

BERAT BUZHALA

VJOLLCA MUSA




ARTAN LAHAJ përfaqësuar nga VJOLLCA MUSA

LEONARD KËRQUKU

SHPEND LIMONH

ARBEN HYSENI

NOTERE/ MERITA KOSTANICA






NJOFTIM-----

KY AKT NOTERIAL PALËVE DHE PËR ORGANET GJEGJËSE U IPET NË FORMË TË  
ESKTRAKTIT/NJOFTIMIT KONFORM NENIT 3.1 TË LIGJIT TË NOTERISË DHE ËSHTË IDENTIK  
ME ORIGJINALIN I CILI RUHET NË ARKIVËN E NOTERIT. -----

Prishtinë 11.09.2018 (njëmbëdhjetë shtator dy mijë e tetëmbëdhjetë). -----

Notere: Merifa Kostanica



**APOSTILLE**  
(Convention de La Haye du 5 Octobre 1961)

1. *Drzava/Conuty* REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/  
REPUBLIC OF KOSOVO  
Ky dokument publik / Ova javni dokument / This public document

2. është firmosur nga/je potpisan od strane/has been signed by M. KOSTANICA

3. i cili vepron në cilësinë e/koji deluje u svojstvu/acting in the capacity of NOTERE


4. dhe mban vulën/pulëu/i zaptar/pečat/pečat/pečat/the seal/stamp of O.N.K.

Vërtetohet / Potvrđuje se / Certified

5. në/uzat PRISHTINE 6. datë/datum/date 12.09.2018

7. nga/od/by DJK/MPJ

8. nr/or/no. 55452/18

9. vulë/pulë/pečat/inarkica/seal/stamp 

10. në shkrimi/poteis/shtypare: 